



Oda e Stomatologëve të Kosovës

Stomatološka Komora Kosova • Dental Chamber of Kosova

RAPORT PËRMBLEDHËS I PUNËS SË ODËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (2019 – 2022)

Prishtinë, mars 2023

PËRMBLEDHJE E AKTIVITETEVE DHE TË ARRITURAVE (2019 – 2022)

1. TRANSPARENCA DHE LLOGARIDHËNIA PËR PUNËN E ODËS, KRIJIMI DHE RISTRUKTURIMI I FAQES ZYRTARE TË ODËS

Ngritja e transparencës dhe llogaridhënia për punën e OSK-së që është çelësi për efikasitetin e udhëheqjes së suksesshme të Odës ka qenë një ndër objektivat kryesore, e bashkë me këtë edhe funksionalizimi i Web-faqes së OSK-së si mjet për realizimin e këtij objekti. **Me 19 Qershor 2019 është bërë edhe lansimi i Web-faqes së OSK-së** (<http://osk-ks.org/>). Nga kjo datë e deri tani, në këtë Web-faqe janë publikuar të gjitha informatat rreth punës së OSK-së, rregulloret, vendimet, raportet e punës njëvjeçare, pasqyrat financiare, raportet e auditorit të jashtëm si dhe çështjet tjera relevante të përditësuara në baza të rregullta, që janë me rëndësi për komunitetin e stomatologëve të vendit. Këto publikime kanë nxit në vazhdimësi llogaridhënien dhe transparencën e punës së OSK-së.

2. KRIJIMI I BAZËS SË TË DHËNAVE PËR STOMATOLOGËT E VENDIT DHE PUBLIKIMI I REGJISTRIT ZYRTAR TË ANËTARËVE TË OSK-SË

Është krijuar Databaza e të dhënave për stomatologët e Republikës së Kosovës. Pas krijimit të Databazës, me 23 Gusht 2019 është publikuar për herë të parë Regjistri i anëtarësisë në Web-faqen zyrtare të Odës. Ky regjistër tani përditësohet rregullisht, poashtu edhe Regjistri i licencave të stomatologëve.

Në këtë periudhë, OSK-ja ka filluar për herë të parë printimin dhe shpërndarjen e kartelave të anëtarësisë.

3. ZHVILLIMI DHE KOMPLETIMI I INFRASTRUKTURËS LIGJORE

Gjatë mandatit katërvjeçar është zhvilluar dhe kompletuar infrastruktura ligjore për funksionalizimin e veprimtarisë së punës së OSK-së, me këto akte normative:

- Rregullore për procedurat e vendimmarrjes të organeve të Odës;

- Rregullore për përcaktimin e llojit të shkeljeve etike dhe procedurat e mbikëqyerjes etike;
- Rregullore për Regjistrim, Licencim/Rilicencim të stomatologëve;
- Rregullore për Edukim të Vazhdueshëm Profesional;
- Vendim për caktimin e lartësisë së taksave administrative në OSK;
- Rregullore për fushëveprimin dhe kompetencat e Komisionit për Çështjet Etike;
- Rregullore për solidaritet dhe ndihmë reciproke për anëtarët e OSK-së;
- Rregullore për menaxhimin e financave të OSK-së;
- Rregullore për zgjedhjen e organeve të OSK-së;
- Rregullore për procedurat e prokurimit;
- Rregullore për udhëtime zyrtare;
- Rregullore për Revistën e Stomatologëve të Kosovës;
- Rregullore për dhënien e dekoratave;
- Rregullore mbi punën e komisionit vlerësues për dhënien e dekoratave;
- Rregullore për marketing;
- Rregullore për organizimin dhe sistematizimin e vendeve të punës në shërbimin profesional të OSK-së.

4. ANËTARËSIMI DHE LICENCIMI I STOMATOLOGËVE

Gjatë periudhës 2019-2022 janë:

- a. Anëtarësuar 764 stomatolog;
- b. Licencuar si doktor i stomatologjisë 725 stomatolog;
- c. Licencuar si specialist 161 stomatolog.

5. LËSHIMI I FAKSIMILIT UNIK

OSK ka zhvilluar të gjitha procedurat e nevojshme për furnizim për punimin/ prodhimin e autorizuar të faksimilit sipas formës së miratuar dhe përmbajtjes të përcaktuar me Rregullore për Regjistrim, Licencim dhe Rilicencim të Stomatologëve.

Stomatologët që licencohen u lëshohen faksimili unik, të prodhuara nën autoritetin e OSK-së.

6. EDUKIMI I VAZHDUESHËM PROFESIONAL (EVP)

Për t'i përmbushur nevojat e anëtarësisë në plotësimin e përgjegjësiave dhe detyrimeve të tyre profesionale në kuadër të EVP-së, Oda e Stomatologëve të Kosovës për këtë periudhë kohore ka organizuar 3 Konferenca stomatologjike me pjesëmarrje ndërkombëtare nga vendet e ndryshme të botës dhe nga të gjitha disiplinat stomatologjike. Në këto konferenca pjesëmarrja e anëtarësisë ka qenë shumë e madhe. Komisioni për Edukim të Vazhdueshëm Profesional (KVEP) gjatë mandatit katërvjeçar ka akredituar aktivitete të ndryshme të subjekteve të autorizuar në kuadër të edukimit të vazhdueshëm profesional, si vijon: 2 kongrese me pjesëmarrje ndërkombëtare, 17 konferenca me pjesëmarrje ndërkombëtare, 2 simpoziume profesionale, 27 kurse profesionale, 18 ligjërata profesionale.

7. ORGANIZIMI I LIGJËRATAVE PROFESIONALE NË QENDRAT RAJONALE TË KOSOVËS

Në kuadër të Edukimit të Vazhdueshëm Profesional, OSK-ja, ka organizuar cikle të ligjëratave profesionale, në shtatë qendrat rajonale, me tema të ndryshme nga praktika stomatologjike. Këto ligjërata janë mbajtur nga ekspertët vendor dhe janë ndjekur nga një numër i madh i stomatologëve.

8. THEMELIMI I REVISTËS SË STOMATOLOGËVE TË KOSOVËS (RSK)

Revista e Stomatologëve të Kosovës, është revista e parë periodike e Kosovës në fushën e stomatologjisë, e themeluar në tetor të vitit 2021 nga Kuvendi i Odës së Stomatologëve të Kosovës. Deri më tani kanë dale dy numra të RSK-së, në formën elektronike dhe të shtypur. Secilit anëtarë të OSK-së nëpërmjet sms elektronik ju është dërguar linku për kyçjen në formën elektronike.

9. ZHVILLIMI I PLATFORMËS DIGJITALE TË OSK-SË

Oda është në fazën e zhvillimit të Platformës digjitale të OSK-së, i cila anëtarësisë do t'i mundësojë qasje efektive on-line për të gjitha shërbimet që ofron OSK-ja. Me këtë, do të avansohen shërbimet administrative të OSK-së në menaxhimin e të dhënave.

10. HARTIMI I DOKUMENTIT MBI STRATEGJINË E ZHVILLIMIT TË STOMATOLOGJISË

Oda e Stomatologëve të Kosovës, pas diskutimeve të nivelit profesional dhe publik, si dhe pas mbajtjes së Tryezës “Gjendja në sektorin e stomatologjisë: e sotmja dhe e ardhmja”, ka hartuar Dokumentin mbi strategjinë e zhvillimit të stomatologjisë në Republikën e Kosovës.

Në këtë dokument është analizuar në mënyrë të përmbledhur e të qartë gjendja aktuale në sektorin e stomatologjisë dhe është hartuar vizioni i OSK-së për reformimin e tij, të bazuar në modelet e përvojat e suksesshme rajonale dhe më gjerë. Suksesi i realizimit të kësaj strategjie zhvillimore kërkon përkushtimin e OSK-së, gjegjësisht profesionistëve të saj, por edhe mirëkuptimin, mbështetjen dhe konsensusin e plotë të të gjitha institucioneve relevante në Republikën e Kosovës.

11. REKOMANDIMET PROFESIONALE TË OSK-SË

- Njëpërmjet Këshillit të Ekspertëve Profesional, OSK-ja, ka hartuar Opinionin profesional lidhur me përdorimin e oksidulit të azotit në praktikën stomatologjike.
- Njëpërmjet Këshillit të Ekspertëve Profesional, OSK-ja ka hartuar Opinionin/udhëzimet profesionale mbi të drejtat dhe përgjegjësitë e doktorit të stomatologjisë në ofrimin e shërbimeve specifike stomatologjike, të cilat i janë drejtuar Ministrisë së Shëndetësisë për miratim.
- Njëpërmjet shkresës për Ministrin e Arsimit dhe Shkencës, kemi kërkuar që gjatë planifikimit të numrit të studentëve të stomatologjise që pranohen në UP dhe Kolegjet private të arsimit të lartë, të merren në konsideratë të dhënat që OSK posedon për numrin e stomatologëve të licencuar në nivel vendi, me qëllim të pengimit të krijimit të kontigjenteve jocilësor të profesionistëve shëndetësor dhe me qëllim të eliminimit të diskrepancës dhe jo proporcionalitetit në mes prodhimit të profesionistëve të rinj të stomatologjisë dhe nevojave të tregut të punës.

12.MBROJTJA E INTERESAVE PROFESIONALE, KONSULTA, INFORMACIONE DHE SHËRBIME TË TJERA PËR ANËTARËT E ODËS

Oda e Stomatologëve të Kosovës ka shprehur përkrahjen pazezervë dhe kontributin e saj për anëtarësinë e saj në zgjidhjen e shqetësimeve dhe kërkesave të tyre.

- Mbështetja e specialistëve të papunë;
- Kërkesa për ekuivalentim të stomatologëve në specializim në kategorinë H7;
- Kërkesa për zbatimin e ligjit për respektimin e rrezikshmërisë në punë drejtuar përmes njoftimit në media;
- Rekomandimet për profesionistët shëndetësorë të sistemit publik dhe privat të kujdesit dentar me rastin e pandemisë së COVID-19;
- Rekomandimet profesionale dhënë MSH-së për miratim: Udhëzimet praktike për profesionistët e stomatologjisë në sektorin privat kundër COVID-19; Formular i pëlqimit për trajtimin e emergjencave/urgjencave stomatologjike; Shërbimet e lejuara stomatologjike në sektorin privat gjatë pandemisë COVID-19;
- Njoftime për anëtarësinë me të reja nga organizatat ndërkombëtare (FDI, ICD etj) lidhur me të dhënat mbi COVID 19;
- Stomatologët e sektorit publik të përfshihen në listat e kompenzimit nga Qeveria e Republikës së Kosovës;
- Propozim për përfshirjen e ambulancave stomatologjike private në planin operacional për pakon fiskale emergjente;
- Mbështetje për përfshirjen e specialistëve të rinj në financim nga programi për subvencione;
- Shkresa drejtuar Ministrisë së Shëndetësië për përfshirjen e stomatologëve të sektorit privat në programin e vaksinimit kundër COVID 19;

- Adresimi i shqetësimeve të anëtarëvësisë të sektorit privat, lidhur me shqiptimin i gjobave nga ana e Inspektoriatit Shëndetësor;
- Adresimi i shqetësimeve dhe brengave të anëtarësisë së sektorit privat, lidhur me mbylljen e veprimtarisë stomatologjike private nga ana e Bordit për licencimin e institucioneve private shëndetësore;
- Adresimi i kërkesave të specializantëve për vështërsitë në realizimin dhe zhvillimin e programit specialistik në të gjitha fushat e stomatologjisë;
- Kemi ngritur çështjen e stomatologëve nga Lugina e Preshevës që janë të ballafaquar me vështërsitë në marrje të licencës dhe lëshimit të faksimilit.
- Kemi ngritur çështjen e papunësisë së stomatologëve në sistemin publik si dhe rishikimi i Udhëzimit Administrativ Nr. 08/2017 në mënyrë që edhe specialistët e stomatologjisë të kenë të drejtën ligjore të ushtrojnë profesionin e tyre në institucionet e kujdesit parësor shëndetësor.

13. BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR

Pjesë e veçantë e programit katërvjeçar ka qenë afirmimi dhe bashkëpunimi me odat profesionale, shoqatat profesionale dhe institucionet tjera të vendeve të ndryshme rajonale dhe më gjërë.

Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me:

- Odën e Stomatologëve të Kroacisë
 - Odën e Stomatologëve të Maqedonisë
 - Urdhrin e Stomatologëve të Shqipërisë
 - Shoqatën e Stomatologëve të Turqisë
 - Fakultetin e Mjekësisë Dentare-Tiranë
-
- Takimi i përbashkët i kryetarëve të odave dhe shoqatave të Stomatologëve nga 21 vendet e ndryshme në kuadër të Platformës së Bashkëpunimit të delegacioneve, mbajtur në Stamboll, organizuar nga Shoqata e Stomatologëve të Turqisë.

- Takimi i kryetarëve të odave nga Maqedonia Veriore, Kroacia, Sllovenia, Kosova, Federata e Bosnjës dhe Hercegovinës, si dhe përfaqësuesi i Urdhërit të Stomatologut të Shqipërisë, mbajtur në Shkup, organizuar nga Oda e Stomatologëve të Maqedonisë.

14. BASHKËPUNIMI ME INSTITUCIONET VENDORE

Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me:

- Qendrën Klinike Stomatologjike Universitare të Kosovës
- Odën e Mjekëve të Kosovës
- Shoqatën e Stomatologëve të Kosovës
- Odën e Infermierëve të Kosovës
- Institutin për hulumtime dhe trajnime në shkencat mjekësore "Rezonanca"
- Shoqatën për të Drejtat e Pacientëve të Kosovës
- Kompaninë dentare "Alianz"
- Kompaninë dentare SH. P. K. "Dental Day"

Në bashkëpunim me odat tjera të profesionistëve shëndetësorë kemi adresuar shumë çështje të përbashkëta që kanë të bëjnë me funksionalizimin e odave si dhe interesave të komuniteteve tona:

- Komunikatë e përbashkët e Odave të e Profesionistëve Shëndetësorë mbi gjendjen e profesionistëve shëndetësorë gjatë pandemisë COVID 19;
- Takimi i OPSH me Ministrin e Shëndetësisë lidhur me punën e odave si dhe çështja e specializimeve;
- Shkresa e përbashkët e OPSH-ve drejtuar Ministrit të Shëndetësisë për bashkërendim lidhur me zbatimin e kompetencave ligjore të Odave të profesionistëve shëndetësor;
- Parashtrimi i kërkesës së përbashkët të OPSH-ve drejtuar Zyres së Kryeministrit të Republikës së Kosovës për anulimin e Udhëzimit Administrativ Nr.05/2017 për Shkollimin Specialistik, pasi që është konstatuar se ky akt nënligjor cënon autorizimet ligjore të bazuara në Ligjin Nr.04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shëndetësorë dhe në Ligjin Nr.04/L-125 për Shëndetësinë,.

- Themelimi Komisionit Ekzekutiv të përbashkët për luftimin, monitorimin dhe reagimin ndaj SarS CoV2 – COVID-19;
- Odat e profesionistëve shëndetësor me kontratë të përbashkët për zbatim-projekti të ndërtimit të objektit të përbashkët;
- Kërkesë e përbashkët e OPSH-ve për incicimin e përsheptimit të ri-draftimit të Projektligjit për Pagat e Zyrtarëve publik;
- Shkresa e përbashkët e OPSH-ve drejtuar Ministrit të Shëndetësisë për mbështetje të Projektit "Ndërtimi i ndërtesës së përbashkët të Odave të Profesionistëve Shëndetësor;
- Realizimi i projektit të përbashkët në ngritjen e monumentit përkujtimor (Obelsikut) në nder dhe përkujtim të kontributit dhe sakrificës së profesionistëve shëndetësor të Republikës së Kosovës, përgjatë dekadave;
- Kërkesa e përbashkët e adresuar kryetarit të Komunës së Prishtinës për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës për ndërtimin e objektit të përbashkët të Odave të Profesionistëve Shëndetësorë (te Pallati i Drejtësisë).

15. NDERIMI I FIGURAVE TË SHQUARA STOMATOLOGJIKE

Në shenjë falënderimi dhe vlerësimi të lartë për kontributin e pazëvendësueshëm në zhvillimin e stomatologjisë kosovare, OSK-ja, ka ndarë dekoratën më të lartë "Nderi i Stomatologjisë Kosovare" për doajenët: Prof. Dr. Beqir Lupçi, Prof. Dr. Rifat Ymeri (post mortem), Prof. Dr. Qamile Jaka (post mortem), Prof. Dr. Jashar Dula (post mortem), Prof. Dr. Adil Raka, Prof. Dr. Hasan Mehmeti, Prof. Dr. Agim Islami, Prof. Dr. Osman Sejfiija dhe Prof. Dr. Veton Hoxha.

16. NDARJA E PARCELËS PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT/ NDËRTESES SË PËRBASHKËT TË ODAVE TË PROFESIONISTËVE SHËNDETËSORË

Kuvendi i Kryeqytetit ka nxjerr vendimin mbi dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë Odave të Profesionistëve Shëndetësorë, për ndërtimin e ndërtesës/objektit të përbashkët (te Pallati i Drejtësisë). Ky vendim është marrë pas kërkesës drejtuar kryetarit të Komunës së Prishtinës nga kryetarët e OPSH-ve dhe faktorëve tjerë shumë të rëndësishëm. Qeveria e Dukatës së Madhe të Luksemburgut-Lux-Dev është mbështetësi kryesor financiar i këtij projekti.

17. AKTIVITETET TJERA

- Takimi i përbashkët me Kryeministrin Hoti, Ministrin e Shëndetësisë Zemaj dhe me Odat e Profesionistëve Shëndetësorë;
- Takimi me Ministrin e Shëndetësisë Dr. Latifin;
- Takimi me Komisionin Parlamentar për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale i Kuvendit të Republikës së Kosovës;
- Takimi me Inspektoratin Shëndetësor;
- Organizimi i punëtorisë për draftimin e Kodit Etik dhe Deontologjisë Stomatologjike;
- Punëtorja e organizuar mbi arritjen e kompetencës të doktorit të stomatologjisë për dhënien e shërbimeve specifike stomatologjike nga implantologjia dhe ortodoncia;
- Organizimi i tryezës së rrumbullakët nga OSK me temë: Gjendja në sektorin e stomatologjisë: E tashmja dhe e ardhmja”.

18.PASQYRA FINANCIARE

- Transparenca e shpenzimeve të parasë nëpërmjet publikimit të raporteve financiare në faqen zyrtare të OSK-së;
- Është siguruar stabiliteti financiar i OSK-së;
- Është instaluar pakoja softuerike Pro-Data Finance, që mundëson regjistrimin e të gjitha informatave financiare dhe nxjerrjen e shpejtë e të saktë të raporteve dhe pasqyrave financiare. Me këtë program kemi avansuar edhe marrjen e gjendjes në kohë reale për secilin anëtar;
- Është bërë regjistrimi në tërësi i mjeteve kryesore dhe të inventarit në përdorim dhe është futur në programin e cekur më lartë;
- Auditimi i pasqyrave financiare dhe auditimi funksional për vitet 2019 – 2022. Në auditimin financiar, auditori i jashtëm ka dhënë opinion të pakualifikuar për pasqyrat financiare të OSK-së. Po ashtu, në aspektin funksional të organeve të OSK-së auditori i jashtëm ka dhënë opinion të pakualifikuar dhe pa ndonjë theksim të çështjes lidhur me funksionimin e organeve të OSK-së.
- Tabela me poshtë paraqet pasqyrimin e të hyrave dhe shpenzimeve në llogarinë kryesore bankare dhe nënlogarinë për fondin për solidaritet për periudhën 2019 – 2022.

LLOGARIA KRYESORE

	2019	2020	2021	2022
Bilanci i hapjes	58,117.52€	61,817.36€	69,301.26€	124,584.78€
Të hyrat	111,491.13€	75,551.18€	162,712.41€	161,960.50€
Shpenzimet	107,791.29€	68,067.28€	107,428.89€	130,965.61€
Bilanci i mbylljes	61,817.36€	69,301.26€	124,584.78€	155,579.67€

LLOGARIA E SOLIDARITETIT

	2019	2020	2021	2022
Bilanci i hapjes	2,000.00€	2,355.40€	4,068.11€	6,312.91€
Të hyrat	363.40€	3,225.51€	2,256.80€	4,590.00€
Shpenzimet	8.00€	1,512.80€	12.00€	3,615.60€
Bilanci i mbylljes	2,355.40€	4,068.11€	6,312.91€	7,287.31€